



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

NJOFTIM

**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 57 dhe 64, pika 2 si dhe mbështetur në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 68, shpall aplikimin për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për vitin akademik 2025-2026.

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e **Gjuhës Angleze** duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të kenë përfunduar studimet universitare 4–vjeçare ose 3 + 2 vjeçare në fushën e gjuhës angleze, me notë mesatare mbi 8.5;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
3. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurojnë.
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
6. Të mos jetë kërkuar nga Departamenti i Gjuhës Angleze zbatimi i kërkesave të parashikuara në Statutin e Universitetit të Tiranës, Neni 75, Përgjegjësia ligjore, Neni 76. procedimi disiplinor, Neni 137, Disiplina, në lidhje me shkeljen e rëndë të etikës në mjediset universitare për shkak të detyrës.

Kritere të veçanta:

1. Përparësi kanë pedagogët e jashtëm, të cilët plotësojnë këto kritere dhe kanë përmbushur plotësisht detyrimet kontraktuale gjatë vitit akademik 2024-2025 dhe u janë nënshtruar procedurave të intervistimit;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e **Gjuhës Gjermane** duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të kenë përfunduar studimet universitare 4-vjeçare (DIND) ose 3+2 vjeçare në gjuhën gjermane.
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurojnë.
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
6. Të zotërojnë të paktën një gjuhë të dytë të huaj të BE-së (përveç gjuhës gjermane).

Kritere të veçanta:

1. Të ketë kualifikime në fushën e mësimdhënies në gjuhën gjermane.
2. Të ketë përvojë pune 3 vitet e fundit pa shpëputje në mësimdhënien e gjuhës gjermane.

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme në **Departamentin e Gjuhës Italiane** nga duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

➤ **Kritere të përgjithshme:**

1. Të kenë përfunduar studimet universitare 4-vjeçare ose 3+2 vjeçare në gjuhën italiane me notë mesatare mbi 8(tetë) në secilin prej cikleve të studimit;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurojnë;
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

➤ **Kritere të veçanta:**

1. Të kenë përvojë në fushën e mësimdhënies së gjuhës dhe kulturës italiane.
2. Të ketë studime pasuniversitare dhe botime në fushën e gjuhësise/letërsise italiane.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme ne **Departamentin e Gjuhës Frënge** duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

➤ **Kritere të përgjithshme:**

1. Të kenë përfunduar studimet universitare 4-vjeçare ose 3+2 vjeçare në gjuhën frënge me notë mesatare mbi 8(tetë) në secilin prej cikleve të studimit.
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurojnë.
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

➤ **Kritere të veçanta:**

1. Të kenë përvvojë në fushën e mësimdhënies së gjuhës dhe kulturës frënge.
2. Të kenë kryer studime pasuniversitare dhe/ose të kenë botime në fushën e gjuhësisë/letërsisë frënge

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme ne **Departamentin e Gjuhës Greke** duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

➤ **Kritere të përgjithshme:**

1. Të kenë përfunduar studimet universitare 4-vjeçare ose 3+2 vjeçare në gjuhën greke me notë mesatare të përgjithshme mbi 8(tetë).
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurojnë.
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
6. Të zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj të dytë (përveç gjuhës greke).

➤ **Kritere të veçanta:**

1. Të ketë përvvojë pune 3 vitet e fundit pa shqëputje në mësimdhënien e gjuhës greke.

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme në **Departamentin e Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike** duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

➤ **Kritere të përgjithshme:**

1. Të kenë përfunduar studimet universitare 4-vjeçare me mesatare 8, (për diplomat e njehësua të ketë së paku një mesatare “mirë”, ose diplomë 3 vjeçare Bachelor me mesatare 8 dhe diplomë 2 vjeçare Master i Shkencave me mesatare 8 në gjuhë dhe letërsi turke, ruse, azerbajxhane, arabe, sllovaqe, polake.
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurojnë.
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

➤ **Kritere të veçanta:**

1. Të ketë përvojë pune dhe akademike në një nga Instiucionet e Arsimit të Lartë, institucione të gjuhës e të kulturës, brenda ose jashtë vendit, së paku 1 (një) vit.

Kandidatët që konkurojnë për personel akademik me kohë të pjesshme ne **Departamentin e Gjuhës Spanjolle** duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

➤ **Kritere të përgjithshme:**

1. Të kenë diplomë universitare 4-vjeçare ose dy cikle studimesh të njëpasnjëshme në gjuhën spanjolle brenda ose jashtë vendit, me notë mesatare të përgjithshme të të dy cikleve 8(tetë) e lart.
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin e punës për të cilin konkurojnë.
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

➤ **Kritere të veçanta:**

1. Të ketë kualifikime në fushën e mësimdhënies së gjuhës spanjolle.
2. Të ketë përvojë pune 3 vitet e fundit në mësimdhënie në arsimin universitar.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

3. Të zoterojë të paktën një gjuhë të dytë të huaj (përveç gjuhës spanjolle).

Shënim:

- Kandidatët që do të përzgjidhen nga konkurimi do të angazhohen në bazë të nevojave të ngarkesës mësimore të Njësive bazë.
- Kandidatët duhet të përballojnë ngarkesën mësimore maksimale prej 120 orë vjetore, të shtrirë gjatë vitit akademik 2025-2026, në përputhje me kërkesat dhe mundësitë e Njësive bazë.

Konkurimi

- Vlerësimi i kandidatëve do të përfshijë dy faza të njëpasnjëshme: vlerësimin e dosjes dhe intervistën.
- Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Shqyrtimi i dosjes do të bëhet nga komisioni ad-hoc që do të ngrihet pranë njësive bazë.
- Kandidatët, të cilët konkurrojnë rishtas do t'i nënshtrohen testimit me gojë (intervistë) përpara komisionit ad-hoc të Njësive bazë.
- Përfshihen nga intervista ish-pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm të Njësive bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si dhe pedagogë të punësuar në Universitete publike në njësi të ngjashme.

Kandidatët që aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës nga data 25.08.2025 – 05.09.2025, dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Dokument identifikimi.
2. Curriculum Vitae (CV).
3. Kërkesë me shkrim.
4. Fotokopje e diplomës (e noterizuar).
5. Fotokopje e listes së notave (e noterizuar).
6. Dëshmi për titujt dhe gradat shkencore (të noterizuar).
7. Dëshmi për kualifikimet dhe aktivitetet lidhur me temën e aplikimit.

Adresa: Rruga "Elbasanit", Tiranë, email: info.fgjh@unitir.edu.al, www.fgjh.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

8. Vlerësimin e punëdhënesit nëse kandidati ka qënë i punësuar me parë.
 9. Në rast të perfundimit të studimeve jashtë vendit kandidati do të paraqesë edhe ekuivalentimin e Diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (të noterizuar).
 10. Dëshmi penaliteti ose formular vetdeklarimi.
 11. Leje (pune) nga punëdhënesi ku punoni aktualisht ose deklaram si i papunë.
 12. Raport Mjeko-Ligjor për aftësinë në punë.
 13. Çertifikatë personale.
 14. Çertifikatë e gjendjes familjare.
- ***Për kandidatët që kanë qënë të angazhuar edhe në vitet e kaluara akademike apo kanë qënë personel akademik me kohë të plotë, kërkohen vetëm ndryshimet në dokumentacionin si më poshtë:***
1. Curriculum Vitae (CV) (të përditesuar).
 2. Kërkesë me shkrim.
 3. Leje (pune) nga punëdhënesi ku punoni aktualisht ose deklaram si i papunë.
 4. Dëshmi penaliteti ose formular vetdeklarimi.
 5. Raport Mjeko-Ligjor për aftësinë në punë.